

PLANET E RIMËKËMBJES DHE TË ZGJIDHJES

Në fillim të vitit 2014, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi dokumentin "Planet e rimëkëmbjes" në të cilin përmbledhen masat e mundshme të rimëkëmbjes për të siguruar kthimin në normalitet të veprimtarisë bankare në rast se materializohen skenarë të ndryshëm që dëmtojnë vazhdimësinë e saj. Këto masa janë konceptuar si zgjidhje me natyrë të jashtëzakonshme, të cilat nuk ndërmerren përgjatë veprimtarisë normale të biznesit. Planet e Rimëkëmbjes synojnë të reduktojnë probabilitetin e dështimit të bankave sistematike.

II.4. SISTEMI I PAGESAVE DHE EMETIMI I MONEDHËS

II.4.1. SISTEMI I PAGESAVE

- Në përmbushje të përgjegjësisë së saj ligjore në fushën e sistemit të pagesave, Banka e Shqipërisë nxit dhe mbështet mirëfunksionimin e sistemit të brendshëm të pagesave në Shqipëri. Me qëllim arritjen e këtij objektivi, Banka e Shqipërisë aplikon tre lloje përqasjesh, të cilat janë plotësuese të njëra-tjetrës dhe bashkëveprojnë ndërmjet tyre: (i) luan rol operacional në ofrimin e sistemeve, (ii) kryen veprimtari mbikëqyrëse, dhe (iii) vepron si reformator i sistemit kombëtar të pagesave.

Gjatë vitit 2014, Banka e Shqipërisë ka përmbushur funksionet e saj si operator, mbikëqyrës dhe katalizator në fushën e sistemeve të pagesave. Me qëllim përaftrimin me praktikata ndërkombëtare dhe ato evropiane në fushën e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave, është rishikuar dokumenti "Politika e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes"³⁶. Nëpërmjet rishikimit është mundësuar një harmonizim i politikave mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë me ligjin "Për sistemin e pagesave" si dhe një përaftrim i funksioneve dhe politikave të Bankës së Shqipërisë me ato të Bankës Qendrore Evropiane. Gjithashtu, nëpërmjet këtij rishikimi mundësohet informimi i tregut mbi parimet për mbikëqyrjen e infrastrukturës së tregjeve financiare, të publikuara nga Banka Ndërkombëtare për Rregullim në prill të vitit 2012, të vëna në zbatim edhe në Shqipëri.

Në përmbushje të funksionit të saj si operatore dhe administratore e sistemeve të pagesave, gjatë vitit 2014, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë masash për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese (sistemit AIPS dhe AECH), dhe për krijimin e infrastrukturave të reja, të tilla si sistemi qendror i regjistrimit dhe i shlyerjes së titujve (AFISaR). Këto zhvillime vlerësohet të kontribuojnë në mënyrë të qenësishme në rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të sistemeve të pagesave, si dhe të krijojnë hapësira të reja për zhvillimin e infrastrukturës së tregjeve financiare. Ato janë shoqëruar edhe me përditësimin dhe përmirësimin e bazës rregullatore të zbatuar.

³⁶ Vendimi nr. 32, datë 30.04.2014 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Me qëllim promovimin e rolit të Bankës së Shqipërisë si katalizator në fushën e sistemit të pagesave dhe konsolidimin e bashkëpunimit ndërinstucional, është hartuar rregullorja "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave"³⁷. Kjo nismë është bazuar në të drejtën dhe detyrimin e gjeneruar nga neni 4 i ligjit nr. 133/2013, datë 29.04.2013 "Për Sistemin e Pagesave". Formalizimi i ndërveprimit midis aktorëve të ndryshëm në këtë fushë do të rrisë efikasitetin e reformave në fushën e sistemeve të pagesave si dhe do të akomodojë nevojat për bashkëpunim përtej aktorëve tradicionalë të fushës. Një praktikë e tillë konsiderohet e domosdoshme nën dritën e praktikave ndërkombëtare dhe më konkretisht të atyre të Bashkimit Evropian.

Viti 2014 ka shënuar përmirësime në cilësinë dhe gamën e të dhënave statistikore për instrumentet e pagesave. Duke pasur si udhërrëfyes praktikën më të mira ndërkombëtare dhe zhvillimet e tregut të shërbimeve dhe sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë rishikoi metodologjinë "Për raportimin e instrumenteve të pagesave". Rishikimi i metodologjisë synon përafrimin e praktikave raportuese me standardet e Bankës Qendrore Evropiane dhe të Bankës Ndërkombëtare për Rregullim dhe mundëson shtrirjen e analizave dhe studimeve edhe në rrafshin rajonal dhe atë ndërkombëtar.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar aktivitetit kërkimor në fushën e pagesave dhe më konkretisht matjes së kostove të instrumenteve të ndryshme të pagesave në ekonominë shqiptare. Banka e Shqipërisë në bashkëpunim të ngushtë me Bankën Botërore, ka punuar për hartimin e metodologjisë të këtij studimi dhe mbledhjen e të dhënave të nevojshme³⁸. Kryerja e një studimi të tillë është vlerësuar shumë efektive nga bankat qendrore të vendeve të zhvilluara si në kuadër të luftës kundër përdorimit të parasë fizike në ekonomi ashtu edhe në kuadër të identifikimit të mundësive për reduktimin e kostove që mbart përdorimi i instrumenteve të pagesave në ekonomi. Realizimi i një studimi të tillë në Shqipëri do të mbështesë analizimin dhe kuptimin e kostove reale dhe sociale të përdorimit të instrumenteve të pagesave, procesin vendimmarrës në kuadër të modernizimit të sistemeve dhe shërbimeve të pagesave, identifikimin e hapësirave për reduktim të kostove në varësi të rezultateve, si dhe nxitjen e dialogut të aktorëve të tregut bazuar në rezultate konkrete.

Funksionimi i infrastrukturës bazë të pagesave kombëtare në lekë ka reflektuar siguri dhe efikasitet

Infrastruktura bazë për kryqëzimin dhe shlyerjen e pagesave kombëtare në lekë ka vijuar të reflektojë siguri dhe efikasitet edhe përgjatë vitit 2014, duke kontribuar në efikasitetin e politikës monetare, në ruajtjen e stabilitetit financiar, si dhe në besueshmërinë e publikut në monedhën kombëtare. Sistemet e operuara dhe të administruara nga Banka e Shqipërisë, "Sistemi i Shlyerjes së Pagesave Ndërbankare me Vlerë të Madhe (AIPS)" dhe "Sistemi

³⁷ Vendimi nr.35, datë 25.06.2014 i Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

³⁸ Po kryhen vrojtime në 1000 individë dhe 700 biznese si dhe në një sërë institucionesh shtetërore të cilat marrin dhe kryejnë pagesa.


i Klerimit të Pagesave me Vlerë të Vogël (AECH)" kanë funksionuar në përputhje me rregullat dhe procedurat përkatëse, duke shmangur situata të jashtëzakonshme.

Kontribut të shtuar në rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të dy sistemeve, AIPS dhe AECH kanë sjellë dhe përmirësimet rregullatore dhe ato infrastrukturore që ka ndërmarrë Banka e Shqipërisë përgjatë vitit.

HAPËSIRË INFORMUESE 4. ECURIA E SISTEMEVE AIPS DHE AECH

AIPS – Sistemi i shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe


Gjatë vitit 2014, aktiviteti i sistemit AIPS ka pasqyruar një rritje të lehtë në vlerë, me 5.56% në terma vjetorë, ndërsa numri i transaksioneve të përpunuara rezulton në të njëjtat nivele me ato të vitit 2013. Gjithashtu, raporti i vlerës së transaksioneve të përpunuara në sistemin AIPS me prodhimin e brendshëm bruto ka paraqitur rritje.



Pasqyrimi i peshave të tipologjive të ndryshme të transaksioneve të përpunuara në sistemin AIPS tregon se në terma të numrit, pagesat për klientë vijojnë të zënë gjithnjë e më shumë peshë. Ky zhvillim vlerësohet të reflektojë përcimin e masave të marra nga Banka e Shqipërisë në mars të vitit 2011*. Në terma të vlerës, vërehet një prani më e madhe e autoritetit monetar në treg dhe një rënie relativisht e lehtë e tregut ndërbankar.

Përgjatë vitit 2014, kredia brenda ditës (KBD)** ka reflektuar një rritje vjetore prej 33.4% në vlerë, ndërkohë që në numër mbetet pothuajse në të njëjtat nivele me ato të vitit të kaluar. Pavarësisht rritjes në terma të vlerës, raporti i financimit të transaksioneve të përpunuara në AIPS nëpërmjet këtij instrumenti mbetet në nivele tejet të ulëta (0.4%) duke nënkuptuar një ekspozim të kufizuar të sistemit ndaj rrezikut të


Grafik 31. Shpërndarja e pagesave të procesuara në sistemin AIPS në numër (majtas) dhe në vlerë (mld lekë, djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

likuiditetit. Gjithashtu, nevojat për likuiditet rezultojnë të kenë qenë të përqendruara në kohë dhe në segmente të kufizuara, duke mos reflektuar sjelljen e tregut në tërësi.

Grafik 32. Ecuria e vlerës së KBD dhe AIPS si dhe raporti i tyre (majtas), dhe ecuria e numrit të KBD dhe vlerës mesatare (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

AECH – Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël


Sistemi AECH ka reflektuar rritje si në terma të vëllimit ashtu edhe të vlerës, edhe gjatë vitit 2014. Krahasuar me vitin 2013, numri i transaksioneve të kleruara është rritur me 22.13% dhe vlera me 14.24%.

Shtimi i pagesave të kleruara në AECH ka ardhur si efekt i kombinuar i rritjes së pagesave nga Ministria e Financave (pjesëmarrësi me peshën kryesore në sistem, prej 54% në numër dhe prej 49% në vlerë) dhe e pagesave të kleruara nga bankat

për llogari të klientëve të tyre. Rritja e pagesave të kleruara nga bankat për të tretin vit radhazi vlerësohet të reflektojë masat e marra nga Banka e Shqipërisë në mars të vitit 2011***.


Pasqyrimi i pagesave të kleruara në sistemin AECH përgjatë seancave, tregon një përqendrim më të theksuar në seancën e parë**** të klerimit të pagesave, krahasuar me dy seancat e tjera. Shmangia e mbingarkesave në flukset e pagesave përgjatë seancës së fundit të klerimit minimizon rreziqet shitesë në kuadër të mirëfunksionimit të sistemeve të pagesave.

Grafik 33. Ecuria e numrit dhe e vlerës së transaksioneve të kleruara në AECH



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 34. Pësia e transaksioneve sipas seancave në AECH për vitin 2014



Burimi: Banka e Shqipërisë.

* Me vendimin nr.12, datë 23.02.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi reduktimin e komisioneve dhe tarifave për këtë sistem, si dhe përcaktimin e një vlere maksimale prej 1500 lekësh për komisionet, të cilat mund të aplikojnë bankat për shërbimet e pagesave në lekë të kleruara dhe të shlyera në AIPS.



**Një instrument i rëndësishëm në sistemin AIPS është Kredia Brenda Ditës (KBD), të cilën Banka e Shqipërisë ia ofron bankave pjesëmarrëse për administrimin e likuiditetit brenda ditës dhe për garantimin e vijueshmërisë normale të funksionimit ndërbankar të pagesave.

***Me vendimin nr.12, datë 23.02.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi: rritjen e vlerës kufi të sistemit AECH nga 1 milion në 1.5 milionë lekë, shtimin e një seance të tretë klerimi në sistemin AECH, diferencimin e tarifave përgjatë seancave dhe reduktimin e komisioneve dhe tarifave për këtë sistem, si dhe përcaktimin e një vlere maksimale prej 500 lekësh për komisionet, që mund të aplikojnë bankat për shërbimet e pagesave në lekë të kleruara në AECH.

****Duhet theksuar fakti se tarifat e aplikuar në pagesat që shlyhen gjatë seancës së parë janë shumë më të lira se ato të seancës së tretë.

Përdorimi i instrumenteve të pagesave, veçanërisht i atyre elektronike, tregon prirje në rritje

Statistikat e përfuara nga bankat tregojnë se gjatë vitit 2014 janë kryer rreth 10.5 milionë pagesa klientësh me një vlerë totale prej 4,289 miliardë lekësh, duke reflektuar një rritje vjetore të numrit me 21% dhe një rritje të vlerës me 18%. Vitin e kaluar është shënuar një rritje e përsheptuar e përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike, veçanërisht shërbimet “Home banking” dhe ato me karta bankare.



Shërbimet “home banking” gjithnjë e më shumë po marrin shtrirje në tregun shqiptar. Pas prezantimit të këtij produkti në vitin 2005 nga një bankë e sistemit, në fund të vitit 2014, numri i bankave që ofrojnë shërbime “home banking” është 11.


Shtimi i numrit të llogarive rrjedhëse të klientëve të aksesueshme nga interneti me 27% krahasuar me vitin 2013 (pas një dyfishimi të tij në vitin 2013), është shoqëruar me një katërfishim të numrit të transakcioneve “home banking” gjatë vitit 2014. Ky rezultat përtej familjarizimit të tregut me këto shërbime si dhe aksesin³⁹ më të gjerë të publikut ndaj këtij shërbimi, reflekton deri diku dhe raportimin më të rregullt të bankave për këtë zë, si rrjedhojë e ndryshimit të metodologjisë së raportimeve.

³⁹ Nëse marrim parasysh faktin se në vitin 2005 ky shërbim është prezantuar si një shërbim i profilizuar kryesisht ndaj bizneseve, tanimë gjithnjë e më shumë ky produkt po u ofrohet dhe individëve.

Përdorimi i llogarive të aksesueshme nëpërmjet internetit rezultojn të jetë rritur. Në vitin 2014 janë kryer mesatarisht rreth 9 transaksione për llogari nga 3 në vitin 2013. Ky shërbim vijon të përdoret më shumë nga bizneset (11 transaksione për llogari) krahasuar me individët (7 transaksione për individ).

Nga perspektiva e përdorimit të kartave si instrument pagese, analizimi i infrastrukturës së ofruar nga bankat e licencuara si emetuese⁴⁰ kartash dikton një rënie të lehtë të numrit të ATM-ëve për vitin 2014 me 2% në terma vjetorë. Rënia e numrit të ATM-ëve vlerësohet të reflektojë vendimet e bankave për mbylljen e disa degëve të tyre. Nga ana tjetër, numri i POS-ëve të ofruara nga bankat e licencuara si pranuese⁴¹ kartash ka shënuar një rritje të konsiderueshme, në masën 8% në terma vjetorë. Pavarësisht rritjes së terminaleve POS, përqendrimi i tyre vijon të jetë i lartë në qarkun e Tiranës⁴², në masën 78%. Nga totali i kompanive të cilat potencialisht⁴³ mund të zotërojnë një terminal POS, vetëm 12% e tyre zotërojnë aktualisht terminale. Kjo shifër mund të jetë akoma më e ulët nëse marrim parasysh se në disa raste kompanitë zotërojnë mbi një POS.

Grafik 37. Zhvillimet e ATM dhe POS, për periudhën 2004 -2014 (majtas), dhe zhvillimet e kartave të debitit dhe të kreditit (djathtas)



Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Në vitin 2014, rritje ka shënuar dhe numri i kartave në qarkullim (7% krahasuar me vitin e kaluar). Nga ndarja e kartave sipas funksionit vihet re një rritje më e përshpejtuar e kartave me funksion krediti, me 32%, krahasuar me atë të kartave me funksion debiti, me 5% në terma vjetorë. Duke iu referuar raportimeve të bankave, në fund të vitit 2014 pesha e kartave të debitit ndaj totalit të kartave në qarkullim ka pësuar një tkurrje të lehtë në 90%, krahasuar me 92% në fund të vitit 2013. Pavarësisht rritjeve pozitive të rritjes së kartave

⁴⁰ Numri i bankave të licencuara si emetuese kartash në Republikën e Shqipërisë, në fund të vitit 2014 rezultojn në 14. Këto banka ofrojnë shërbime të tërheqjes cash nga ATM-të.

⁴¹ Në fund të vitit 2014, 7 banka rezultojnë njëkohësisht të licencuara edhe si pranuese kartash. Këto banka ofrojnë shërbimin e pranimit të pagesave me karta nëpërmjet pajisjeve POS të vendosura në dyqane, restorante, hotele apo dhe në qendra tregtare.

⁴² Ndarja e qarqeve bëhet sipas degëve të Bankës së Shqipërisë.

⁴³ Këtu përfshihen kompanitë të cilat kryejnë tregti me pakicë si dhe hotele e restorante.

të debitit dhe të kreditit, përqindja e llogarive të cilat aksesohen nëpërmjet një karte debiti apo krediti rezulton në nivele relativisht të ulëta (25% ndaj totalit).

Tabelë 9. Transaksionet me karta sipas terminaleve

	Vëllimi			Vlerë (në milionë lekë)		
	2012	2013	2014	2012	2013	2014
1- ATM tërheqje cash	11.300.261	11.729.920	12.205.989	109.609	117.195	125.048
2- ATM depozitime	5	21	6	0,03	0,09	0,01
3- Urdhërtransferta nëpërmjet ATM	80	61	40	0,68	0,75	0,65
4- Tërheqje cash në terminale POS	3.450	3	881	475	460	113
5- Pagesa me karta në terminale POS	1.107.425	1.496.640	2.124.304	13.396	12.511	17.921
nga të cilat:						
- pagesa me karta debiti	656.000	864.730	1.212.278	4.739	5.738	7.914
- pagesa me karta krediti	451.425	631.910	912.026	8.657	6.772	10.006
Totali i transaksioneve me karta	12.411.221	13.226.645	14.331.220	123.481	130.167	143.084

Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Rritja e numrit të kartave bankare (debiti dhe krediti) duket të jetë shoqëruar edhe nga një rritje e transaksioneve me karta, ku peshën kryesore vijojnë ta kenë transaksionet për tërheqje cash. Gjatë vitit 2014, në total janë procesuar rreth 14.3 milionë transaksione me karta (në ATM dhe POS-e) me një qarkullim total prej 143 miliardë lekësh. Nga totali i transaksioneve, rreth 85% në numër dhe 87% në vlerë, e përbëjnë transaksionet nga ATM-ëtë.

Pavarësisht mbizotërimit të përdorimit të kartave për shërbime bazike, edhe përgjatë këtij viti, është vënë re një rritje e pagesave me karta në POS-et fizike dhe ato virtuale⁴⁴. Shpërndarja e pagesave në POS-e fizike dhe virtuale tregon për një mbizotërim në masën 70% të pagesave me karta në të parat. Ky zhvillim dikton një familjarizim gjithnjë e në rritje të tregut shqiptar me përdorimin e kartave bankare në transaksionet e tyre të përditshme. Nga ana tjetër, ai nënvizon faktin se zhvillimi i tregtisë elektronike në vend përbën një potencial për shtimin e pagesave me kartë, duke rritur mundësitë për blerje në internet.

II.4.2. EMETIMI I MONEDHËS

KARTËMONEDHA NË QARKULLIM⁴⁵

Sasia e kartëmonedhave në qarkullim, në fund të vitit 2014, ishte 130,654,519 copë me vlerë rreth 222.896 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2013, rezulton pothuajse i njëjti numër kartëmonedhash, ndërkohë që vlera regjistron një rritje në masën 9.06%. Kjo rritje pasqyron ndryshimin që ka pësuar struktura në favor të kartëmonedhave me vlerë nominale 5000 Lekë dhe 2000 Lekë. Gjithashtu, vëllimi i kërkesave nga bankat e nivelit të dytë për pagesa pati rritje.

⁴⁴ Është pajisja e ngjashme në shërbime me terminalin POS, e cila mundëson kryerjen e transaksioneve nëpërmjet internetit ose telefonave, me anë të kartave bankare që punojnë në regjim online.

⁴⁵ Është numri dhe vlera e kartëmonedhave dhe monedhave të hedhura në qarkullim nga Banka e Shqipërisë.